



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 87, dt. 13.04.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 13.04.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e Hec-eve Shkopet 2 dhe 3 , në pjesën e poshtme të Hec-it ekzistues Shkopet, në luginën e lumit Mat, Qarku Lezhë.
2. Shoqëria të kontribuojë për zëvendësimin e elementëve që mungojnë të objektit monument kulture kategoria e I-rë, Ura e Matit, e cila sipas këtij projekti është rreth 1150 m larg godinës së heceve Shkopet 2 dhe 3. Punimet për zëvendësimin e këtyre elementeve të bëhen nën mbikqyrjen e specialistëve të DRKK-së Shkodër.
3. Ngarkohet DRKK Shkodër për korrespondencën në vazhdim me shoqërinë dhe vënien në dijeni të Këshillit Kombëtar të Restaurimit për zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi.
4. Gjatë procesit të zbatimit, të projektit për ndërtimit të Hec-eve Shkopet 2 dhe 3, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI